



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA E TIRANËS
AGJENCIA E PARQEVE DHE REKREACIONIT
NJËSIA E PROKURIMIT

Data 31.10.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Shpenzime për dekorimin e PMLAT për festat e fundvitit”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

39298910-9 Pema e krishtlindjeve

39298900-6 Sende të ndryshme dekorativë

45451000-3 Dekorime

VLERA E FONDIT LIMIT:

Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

Fondi limit i procedurës është: 6.500.000 (gjashtëmilion e pesëqindmijë) lekë, pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “**Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 76 dhe 82 të LPP Nr. 162 datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenin 26 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshime, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të LPP. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik...”

b. **Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës: 130.000 (njëqind e tridhjetëmijë) lekë pa TVSH, të lëshuar në formën e garancisë bankare, nga shoqëri sigurimesh të licensuara nga Autoritetet përkatëse ose pagese e kryer në numrin e llogarisë së Autoritetit Kontraktor.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 83 të LPP, nenit 30, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku mes të tjerave citohet se: “...Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës

nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël...”

“...Autoriteti/enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit vlerën e sigurimit të ofertës, e cila është sa 2% e vlerës së fondit limit të kontratës ose lotit. 3. Në dokumentet e tenderit duhet të parashikohet një periudhë vlefshmërie, bazuar në kohëzgjatjen e mundshme të procedurës. Sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm gjatë gjithë kësaj periudhe...”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1.1 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatën ISO 9001:2015 ose ekuivalente (e vlefshme) “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” e cila të përfshijë objektin e prokurimit (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikatën ISO).

Certifikata e mësipërme, duhet të jetë e lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të cilët janë të akredituara nga organizmi kombëtar i akreditimit, ose nga organizmat ndërkombëtarë akreditues.

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Nisur nga përcaktimet e mësipërme në rastin kur ofertuesit paraqesin oferte në formën e bashkimit të operatorëve ekonomikë u vlerësua si e nevojshme që në këtë rast secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të jetë i pajisur me certifikatën e cilësisë ISO **9001-2015** pasi këto janë kërkesa që e parashikon legjislacioni në rastin e kualifikimeve që i referohen kualifikimeve të ofertuesit, si dhe është e lidhur ngushtë dhe në proporcion me objektin e prokurimit, pasi kanë lidhje me sigurinë e cilësisë së mallit që do të furnizohet, pra cdonjëri nga anëtarët e bashkimit të shoqërive që merr përsipër të furnizojë në një përqindje të caktuar për këtë objekt prokurimi duhet të disponojë certifikatën e cilësisë së mallit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës e fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, sa 40 % vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin përcaktohet se:

” 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar

kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës.

Nisur nga sa është përcaktuar në këtë dispozitë, meqënëse autoriteti kontraktor kërkon që të garantohet se operatori ekonomik ofertues e ka kapacitetin ekonomik të nevojshëm për realizimin e objektit të prokurimit, pra që të këtë realizuar xhiron vjetore, njësia e prokurimit vendosi që të hartonte dhe përcaktonte këtë kërkesë për kualifikim.

Meqënëse procedura e prokurimit e përzgjedhur është e llojit "Procedura e Hapur e thjeshtuar– Mallra" ju referuam edhe përcaktimeve të nenit 43, pika 1 e 2 "Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare", dhe Kreu II "Kufijtë monetarë" të VKM nr. 291, datë 15.05.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetare në procedurat e prokurimit publik", i ndryshuar, ku përcaktohet se:

Neni 43

Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare

Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...;

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.;

KREU II

KUFIJTË MONETARË NË SEKTORIN KLASIK

1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon:

a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë;

b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

Lidhur me vitet financiare për të cilat kërkohet që të jetë e realizuar xhiro e kërkuar, njësia e prokurimit duke ju referuar përcaktimeve të nenit 43, te VKM nr. 285, datë 15.06.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar ku është përcaktuar se deklarata e xhiros vjetore mund të kërkohet deri në tre vitet e fundit financiare, si dhe nisur nga përcaktimi i pikës 7 të Rekomandimit të APP Nr.7998 datë 24.12.2021 "Mbi hartimin e kriterëve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra, punë, shërbime" ku përcaktohet se në nenin 19 të ligjit nr 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, deklarata vjetore e të ardhurave nga subjektet tatim paguese deklarohet në organe tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, prandaj njësia e prokurimit meqënëse procedura e prokurimit do të zhvillohet

në tetor të vitit 2024 dhe tatimpaguesit kanë afat deri më 31 mars 2024 të deklarojnë xhiron e realizuar në vitin 2023 përcaktoi si 3 (tre) vite të fundit financiare vitet 2021, 2022 dhe 2023.

Lidhur me vlerën e xhiros vjetore të përcaktuar, meqënëse procedura e mësipërme e prokurimit është nën kufirin e ulët monetar u përcaktua që vlera e xhiros vjetore të jetë sa 40% e vlerës së fondit limit.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, gjithashtu është kërkuar auditimi ligjor i pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese në rastet e parashikuara në nenin 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas përcaktimeve të Ligjit nr Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Njesisë së Qeverisjes Vendore ku operatori ekonomik ka selinë.

Kjo kërkesë do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. *Dokumentacioni provues, për shlyerjen e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet vetëm nga Operatori Ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, sipas përcaktimeve të bëra në pikën 6, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në përputhje me nenin 76, pika 2, gërma b të LPP, i ndryshuar si dhe në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore“ i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore për vitin 2024 në të gjitha vendet ku ushtron aktivitet ekonomik sipas të dhënave të QKB-së.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate konkretisht: *1.300.000 (një milion e treqindmijë) lekë pa Tvsh .*

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për shërbime të mëparshme të ngjashmetë realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur Kontratën e nënshkruar me institucionin, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e suksesshëm të kësaj kontrateku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të ngjashme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të

legjislaconit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të lëshojnë deklaratë nëpërmjet të cilës merr përsipër transportin dhe shkarkimin vendosjen, montimin dhe çmontimin pas mbarimit të afatit të qëndrimit si dhe paketimin dhe transportin në magazinat e autoritetit kontraktor.

Argumentim: Kërkesa për operatorët ekonomikë që të lëshojnë një deklaratë për marrjen përsipër të transportit, shkarkimit, vendosjes, montimit, çmontimit, paketimit dhe transportit në magazinat e autoritetit kontraktor është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të kenë të specifikuara përgjegjësitë e tyre, duke garantuar se ata janë të vetëdijshëm për detyrimet e tyre ligjore dhe operacionale. Proceset e transportit, montimit dhe çmontimit kërkojnë kujdes të veçantë për të siguruar që asnjë dëm të mos i shkaktohet materialeve. Kjo deklaratë siguron se operatorët do të veprojnë me standarde të larta të sigurisë dhe cilësisë krijon një dokumentacion të qartë që mund të përdoret për të verifikuar gjatë afatit të zbatimit të kontratës përmbushjen e detyrimeve nga ana e operatorëve ekonomikë, duke ndihmuar në menaxhimin e riskut dhe transparencën në proces.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë nga administratori i shoqërisë që garanton mbulimin e periudhës për funksionimin normal të elementëve të dekorit nga momenti i instalimit deri më 17 Janar të vitit 2025.

Argumentim: Kërkesa për një deklaratë nga administratori i shoqërisë që garanton mbulimin e periudhës për funksionimin normal të elementëve të dekorit deri më 17 Janar 2025 është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë siguron që operatori ekonomik angazhohet për të mbajtur elementët e dekorit në një gjendje funksionale gjatë gjithë periudhës së parashikuar, duke garantuar që ato do të funksionojnë siç është e nevojshme për të përmbushur kërkesat e operatorit ekonomik. Duke kërkuar një deklaratë nga administratori, autoriteti kontraktor e bën të qartë se cila është përgjegjësia e operatorit për mirëmbajtjen dhe mbështetje të elementëve të dekorit, duke ndihmuar në evitimin e paqartësive në rast të ndonjë problemi. Duke garantuar funksionimin normal të elementëve të dekorit, operatori ndihmon në mbrojtjen e investimeve të autoritetit kontraktor, duke minimizuar rrezikun e humbjeve financiare për shkak të dëmtimeve ose defekteve. Sa më sipër argumentuar, kërkesa për një deklaratë të tillë është thelbësore për menaxhimin e suksesshëm të kontratës dhe për sigurimin e një funksionimi të qëndrueshëm të elementëve të dekorit.

2.3.4 Numri mesatar i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se **15 (pesëmbëdhjetë) punonjës** për periudhën e **tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.

b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e tre muajve të fundit nga dita e hapjes së ofertave.

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në mbështetje të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kjo kërkesë garanton që operatori ekonomik ka numrin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm të punonjësve për të përmbushur detyrat e përcaktuara për realizimin e objektit të kontratës, duke siguruar që kontrata do të realizohet në mënyrë efikase dhe në përputhje me standardet e kërkuara. Një numër i mjaftueshëm punonjësish ndihmon në ruajtjen e cilësisë së procesit të furnizimit dhe vendosjes së dekorit dhe realizimin e kontratës brenda afateve të parashikuara duke minimizuar rrezikun e vonesave ose problemeve të tjera që mund të ndodhin në procesin e dekorimit dhe duke krijuar një ambient më të qëndrueshëm për realizimin e kontratës. Sa më sipër numri i punonjësve është thelbësor për të siguruar një menaxhim efikas dhe cilësor të kontratës së dekorimit.

2.3.5 Operatori ekonomik, në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, duhet të depozitojë pranë Agjencisë së Parqeve dhe Rekreacionit, mostrat e artikujve si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Profil alumini 20	cm	50
2	Lame alumini 12X1.5mm	cm	50
3	Profil hekuri i lyer 40	cm	50
4	Profil hekuri i lyer 30	cm	50
5	Profil hekuri i lyer 20	cm	50
6	Tel i mbushur 8 mm	cm	50
7	Fasheta plastike 10 cm	cope	10
8	Drita që do të përdoren per plotesim elementet (të ngrohta, te kuqe te bardha) +aksesore që të ndizet per prove	Pako	1 pako/10m per cdo ngjyre

9	Ndricues tubular që do të përdoret për elementet +aksesore qe te ndizet per prove	m	2
10	Varg jeshil pvc që do të përdoret për veshjen e sipërfaqes se pemës	cope	1
11	Tapet ose shirita dekorativ me ngjyra	cm ²	30 cm ² per cdo ngjyre
12	Element dekori per pemen +aksesore qe te ndizet per prove	cope	1 cope/model

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e AK.
- Cdo muster e paraqitur pas orarit te percaktuar per hapjen e procedures nuk do te pranohet.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse.
- Mosparaqitja e mostrave është kusht për s’kualifikim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40 pika 6, germa (a), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kërkesa për paraqitjen e mostrave të mallit i ofron mundësinë autoritetit kontraktor për të vlerësuar cilësinë e materialeve të propozuara, duke siguruar përputhshmërinë me specifikimet teknike dhe estetike që janë parashikuar në dokumentet e tenderit, duke garantuar se materialet e përdorura janë të duhura. Mostrat lejojnë autoritetin kontraktor të vlerësojë se si materialet do të duken në kontekstin e përgjithshëm të dekorimit, duke ndihmuar në marrjen e vendimeve më të informuara për dizajnin e hapësirës. Të pasurit e mostrave të materialeve ndihmon në parandalimin e problemeve të mundshme që mund të lindin pas përfundimit të punimeve, siç janë dështimet në ngjyrë, teksturë ose qëndrueshmëri. Kërkesa për mostra tregon angazhimin e ofruesve për transparencë dhe cilësi, duke kontribuar në një marrëdhënie më të fortë dhe më të besueshme mes autoritetit kontraktor dhe operatorëve ekonomikë.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar duke u bazuar në parametrat e lejuara dhe sipas standardeve në fuqi, të cilat përmbushin kërkesat dhe nevojat e AK. Specifikimet teknike për artikullin e kërkuar, përshkruajnë tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërës, që garantojnë cilësinë e kërkuar dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (neni 36), dhe VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (neni 40 pika 2).

Specifikime teknike për zërat sipas renditjes në tabelën e mësipërme:

1. Prodhim Instalacion dekorativ 3d në formë harku/porte me kalim poshtë.

- Përmasa 560x640x140 cm, hapësira në mes për të kaluar qytetarët 300x280cm
- Gjithë gjatësia lineare e elementit duhet të jetë e konturuar me ndriçues tubular, po ashtu dhe sipërfaqja e elementit e thurur me drita afër njëra-tjetrës, jo më pak se 100 llampa led/m².

- Instalacioni duhet të ketë pjesë të design elemente dekori si tekst i konturuar me ndriçues “Gëzuar 2025” dhe slogan urimi për festa (jo më shumë se pesë fjalë) sihluta figura festive, të gjitha të konturuara dhe të mbushura me elemente të ndriçuar.

Struktura mbajtëse hekuri.

- Profil 20x20 mm dhe lama 12x1.5 mm tel me diametër 8mm i mbushur.
- Struktura të jetë e lyer.

Detajet specifike të tubolarit:

- Dritë tubLED – 30 LEDs/m – 2.50 m – 2,00 W/m – 230V.
- Kod mbrojtje: IP rate: IP44-67
- Përdorimi: Për përdorim të jashtëm.
- Kabull korenti 3x1.5, izolant + kanalina të nevojshme për izolim kabulli nëse është e nevojshme.
- Të gjitha produktet e ndriçimit të jenë të markuara CE certifikatë.

2. Prodhim Instalacion dekorativ 3D për rrethrotullimin afër digës

- Përmasat e instalacionit duhet të mbulojnë një sipërfaqe minimumi 25 m² (6x4m ose 5x5m)
- Elementi duhet të qëndrojë vertikalisht për vizibilitet, në mes të rrethrotullimit qëndron një shtyllë e cila do t’i shërbejë këtij instalacioni si pjesë e tij dhe në funksion të tij. Trashësia e instalacionit jo më pak se 130 cm.
- Instalacioni duhet të përmbajë në design sihluta festive, globa minimalisht 1m, jo më pak se 3 copë pemë festive të lartësive të ndryshme me drita dhe elemente dekori me tematikën e festave të fundvitit. Instalacioni duhet të ketë pjesë të design elemente dekori si tekst i konturuar me ndriçues “Gëzuar 2025” dhe slogan urimi për festa (jo më shumë se pesë fjalë). Detajet specifike të aluminit që do të ndërtohen si figura dekorative janë:
- 240V, 100LEDs/10SET lidhje me seri me këllëf dhe silikon në cdo llampë, IP44-67, kabull gome, convertor+IP44. Dritë e ngrohtë 20% me blice ngjyra kabullit jeshil (ngjyrat e mundshme të dritave që do të përdoren të ngrohta, të ftohta, të kuqe)

Detajet specifike të tubolarit:

- Dritë tubLED – 30 LEDs/m – 2.50 m – 2,00 W/m – 230V, (ngjyrat e mundshme të tubolarit i ngrohtë, i ftohtë, i kuq)
- Kod mbrojtje: IP rate: IP44-67
- Përdorimi: Për përdorim të jashtëm.
- Kabull korenti 3x1.5, izolant + kanalina të nevojshme për izolim kabulli nëse është e nevojshme.
- Të gjitha produktet e ndriçimit të jenë të markuara CE certifikatë.

3. Prodhim Instalacione dekorative festive 650x330-350cm që do të vendoset nga toka në formë të harkuar me bazamente qëndrimi nga dy anë.

- Detajet specifike të hekurit që do të ndërtohen si figura dekorative janë:
- Profil hekuri 20x20 mm i lyer me bojë si dhe me antiruxho

Detajet specifike të dritë që do të thuret si figura dekorative janë:

- Dritë tubLED – 30 LEDs/m – 2,50 m – 2,00 W/m – 230V.
- (ngjyrat e mundshme të tubolarit i ngrohtë, i ftohtë, i kuq)
- Kod mbrojtje: IP rate: IP44-67

- Përdorimi: Për përdorim të jashtëm.
 - E gjithë gjatësia lineare e elementit duhet të jetë e konturuar me ndriçues tubolar.
- Detajet specifike të dritës që ndërtohen figura dekorative janë:

- 24V, 100LEDs/10M/SET, lidhje seri me këllëf dhe silikon në çdo llampë, IP44-67, kabulli +3A
- Konvertor+IP44+
- Transformator 240/24V/60Ë
- Furnizimi me energji elektrike me tension të ulët.
- Ngjyra e dritave të jenë të ngrohta, të bardha dhe të jenë me 20% flash kabull i bardhë.
- Struktura duhet të jetë e mbushur në të gjithë sipërfaqen e saj me drita.
- Tubolari dhe dritat të jenë të thurur me fasheta me strukturën mbajtëse.
- Kabëll korenti 3x1.5, izolant + kanalina të nevojshme për izolim kablli nëse është e nevojshme.
- Të gjitha produktet e ndriçimit të jenë të markuara CE certifikatë

4. **Prodhim instalacione dekorative festive me lartësi 430x350cm të vendosura në tokë, me dy figura përbërëse.**

Figura përbëhet nga dy pjesë:

Pjesa 1 – **Figurë 3D baza 50cmx50cm prizëm i harkuar me një gjatësi lineare 500cm me një krah që të arrijë minimumi 2.2m zgjerim, e kapur mbi një pllakë mbajtëse llamarine 5mm me përmasa 50x100cm.**

Detajet specifike të hekurit që do të ndërtohen figura dekorative janë:

- Profil hekuri 20x20mm i lyster me bojë dhe antiruxho.
- Detajet specifike të dritës që do të thuret figura dekorative, janë:
- Detajet specifike të tubolarit:
- Dritë tubLED-30LEDs/m-2,50m – 2,00W/m – 230V.
- Kod mbrojtje: IP rate: IP44-67
- Përdorimi: Për përdorim të jashtëm.
- Gjithë gjatësia lineare e elementit duhet të jetë e konturuar me ndriçues tubolar

Detajet specifike të dritës që ndërtohen figurat dekorative janë:

- 24V, 100LEDs/10M/SET, lidhje seri me këllëf dhe silikon në çdo llampë, IP44-67, kabulli +3A
- Konvertor+IP44+
- Transformator 240/24V/60Ë
- Furnizimi me energji elektrike me tension të ulët.
- Ngjyra e dritave të jenë të ngrohta, të bardha dhe të jenë me 20% flash kabëll i bardhë.
- Struktura duhet të jetë e mbushur në të gjithë sipërfaqen e saj me drita.
- Tubolari dhe dritat të jenë të thurur me fasheta me strukturën mbajtëse.
- Kabëll korenti 3x1.5, izolant + kanalina të nevojshme për izolim kablli nëse është e nevojshme.

5. **Pjesa 2** – **Prodhim instalacione festive figura 2D 160x150cm që do të bashkëngjitet strukturës së pjesës 1.**

- Detajet specifike të aluminit që do të ndërtohen figurat dekorative janë:
- Strukturë alumini

- Lamë 12x1.5mm
- Detajet specifike të dritës që ndërtohen firgurat dekorative janë:
- 240v,100LEDs/10M/SET, lidhje seri me këllëf dhe silikon në çdo llampë, IP44-67,
- Kabëll i gomuar
- Konvertor + IP44
- Dritë e ngrohtë 20% me blice
- Ngjyra e kabllit jeshil

Detajet specifike të tubolarit:

- Dritë tubLED – 30 LEDs/m – 2.50 m – 2,00 W/m – 230V.
- Kod mbrojtje: IP rate: IP44-67
- Përdorimi: Për përdorim të jashtëm.
- Kabull korenti 3x1.5, izolant + kanalina të nevojshme për izolim kabulli nëse është e nevojshme.

Të gjitha produktet e ndriçimit të jenë të markuara CE certifikatë

6. Prodhim Instalacion dekorativ 3D Kristale të mëdha 700cmx250cmx30cm

Detajet specifike të aluminit që do të ndërtohet figura dekorative janë:

- Strukturë alumini, lame 12x1.5mm

Detajet specifike të dritës të ndërtohen figura dekorative janë:

- 24V, 100LEDs/10M/SET, lidhje seri me këllëf dhe silikon në çdo llampë, IP44-67, kabëll+3A
- Konvertor + IP44
- Transformator 240/24V/60W
- Furnzimi me energji elektrike me tension të ulët.
- Struktura duhet të jetë e mbushur në të gjithë sipërfaqen e saj me drita.
- Tubolari dhe dritat të jenë të thurur me fasheta me strukturën mbajtëse.
- Kabëll korenti 3x1.5, izolant + kanalina të nevojshme për izolim kablli nëse është e nevojshme.
- Të gjitha produktet e ndriçimit të jenë të markuara CE certifikatë

7. Prodhim Pemë konike me lartësi 9m

- Struktura konike hekuri me diametër në bazë 4m.
- Profil që do të përdoret 40x40mm, 30x30mm, 20x20,, dhe tel i mbushur me diametër 8mm.
- Struktura konike të jetë e lyster.
- Vargje jeshil pvc që të mbulojnë gjithë sipërfaqen e strukturës me denduri që struktura të jetë e padukshme.
- Detajet specifike të dritës që do të thuret pema janë: 240V, 100LEDs/10M/SET, lidhje seri me këllëf dhe silikon në çdo llampë,
- Kod Mbrojtje: IP44-67
- Kabëll i bardhë ose jeshil
- Elemente dekori 2D me ndriçues tubolar – 20 copë jo më të vogla se 50cm.
- Lule dekorative festive me nje diametër jo më pak se 35cm
- Përdorimi: Për përdorim të jashtëm.
- Kabëll korenti 3x1.5, izolant + kanalina të nevojshme për izolim kablli nëse është e nevojshme.
- Pedanë hekuri 500x500x20 cm për nivelim sheshi ku do të vendoset pema.

- Të gjitha produktet e ndriçimit të jenë të markuara CE certifikatë

8. Kabëll korenti 3 x1.5 për të gjitha instalacionet. Nga matjet në terren nevojitet 1500 m gjithsej kabëll korenti.

Kablli duhet të jetë i pajisur me izolant + kanalina të nevojshme për izolim kablli nëse është e nevojshme.

Argument: Specifikimet teknike në tërësi pasqyrojnë kërkesat e autoritetit kontraktor, duke marrë parasysh stilin, ngjyrat, materialet dhe funksionalitetin e dëshiruar për hapësirën që do të dekorojë. Elementët e dekorit janë specifikuar të përshtatshëm për ambientin ku do të vendosen duke përfshirë aspekte si qëndrueshmëria në kushte të ndryshme klimatike, estetikën që i përshtatet hapësirës, dhe përputhshmërinë me elementët ekzistues të hapësirës që do të dekorohet. Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me standarte që përcaktojnë kërkesat për cilësinë e materialeve, sigurinë dhe performancën.

Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.